


Kali i qyqes

Kali i qyqes (*Neophron peronopterus*) është një shkabë me gjatësi trupore prej 55 deri në 65 cm dhe ka një gjatësi të hapjes së krahëve prej 155 deri në 170 cm. Të rriturit janë të bardhë dhe krahët e fluturimit i kanë ngjyrë të zezë, ndërsa puplaja e zogjve të kalit të qyqes është ngjyrë kafe e errët. Fytyra ngjyrë e verdhë në portokalli e bën këtë shpend lehtësisht të dallueshëm.

Kali i qyqes konsiderohet si shpend inteligjent dhe njihet për aftësinë për të përdorur mjete, si p.sh. gurët për të thyer vezët me të cilat ushqehen, apo shkopinj të për të sistemuar materialin prej leshi në foletë e tyre.

Kali i qyqes është shkaba e fundit folezuese në Shqipëri. Shkaku kryesor që ka çuar në rënien e popullatës së kalit të qyqes është helmimi.



Duke qenë shpend kërmangrënës, ky lloj bie lehtësisht pre e kurtheve me helm, një praktikë kjo tejet e përhapur në zonat rurale të Shqipërisë.

Popullata e kalit të qyqes në Shqipëri është reduktuar në vetëm 6 çifte folezuese. Në të gjithë Ballkanin nuk i kalon 50 çifte.

Kali i qyqes përshkon më tepër se 5000 km për të udhëtuar nga Afrika drejt vendeve të folezimit, si Gadishulli i Ballkanit apo zona të tjera në Evropë. Shtegtimi i tij është i mbushur plot peripeci, duke u konsideruar si një fluturim për mbijetesë.



Lejleku

Lejleku (*Ciconia ciconia*), si një shtegtues i distancave të gjata, fluturon rreth 20 000 km çdo vit drejt territoreve të folezimit dhe anasjelltas, duke u përballur me një sërë kërcënimesh. Ai dimëron në kontinentin Afrikan, ndërkohë që në vendet e folezimit renditet edhe Shqipëria. Popullata e lejlekut në vendin tonë numëron rreth 10 çifte folezuese, të shtrira në jug të vendit përgjatë luginës së Drinos dhe zonës së Delvinës. Humbja e vendeve të folezimit, elektrohoku dhe përplasje me linjat e energjisë janë disa nga faktorët që kërcënojnë popullatën e lejlekut, duke e bërë atë një lloj të rrezikuar në mënyrë kritike për zhdukje (CR) në Shqipëri.



Statusi
i Kalit të
qyqes
në nivel
global



Statusi i
Lejlekut
në
Shqipëri

Fluturimi për mbijetesë

Fluturimi për mbijetesë është një fushatë e iniciuar nga BirdLife International me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi rreziqet që i kanosen shpendëve përgjatë shtegtimin të përvitshëm nga vendet e folezimit drejt atyre të dimërimit dhe anasjelltas. Fokusi i fushatës së Fluturimit për Mbijetesë në Shqipëri janë 9 lloje shpendësh shtegtues, ku ndër të tjerë mund të përmendim kalin e qyqes (*Neophron percnopterus*) dhe lejlekun (*Ciconia ciconia*).


Rreth 206,000 - 325,000 shpendë vriten ose kapen çdo vit në Shqipëri, duke renditur vendin tonë në 10 vendet më të rrezikshme në Mesdhe për vrasjen e paligjshme të shpendëve.



PPNEA dhe organizata të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare kanë punuar ndër vite për uljen e rreziqeve që i kanosen popullatës së kalit të qyqes dhe lejlekut, duke u përpjekur për rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror, si dhe duke ndërmarrë aksione të drejtpërdrejta ruajtëse. Një nga këto aksione ruajtëse është edhe ngritja e dy stacioneve me ushqim plotësues në afërsi të territoreve të kalit të qyqes, me qëllim uljen e rrezikut të helmimit, apo edhe instalimi i platformave folezuese për lejlekun, të cilat kanë rritur mundësitë për riprodhim dhe mbijetesë të tij.

Mëso më tepër për fluturimin për mbijetesë të këtyre llojeve duke vizituar faqen flightforsurvival.org


Skano këtu për t'ju bashkuar përpjekjeve për ruajtjen e kalit të qyqes dhe lejlekut në vendin tonë.



In partnership with

HEINRICH BÖLL STIFTUNG
The Green Political Foundation
TIRANA

Supported by



Agjencia Zëritarë për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Funded by
the European Union



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Tirana



AMBASSADE
DE FRANCE
EN ALBANIE



ITALIAN AGENCY
FOR DEVELOPMENT
COOPERATION



vodafone



FLUTURIMI PËR MBIJETESË

Kali i qyqes
dhe Lejleku



Albania is Biodiversity